



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Gjykimin e çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 18, të vitit 2023, në ngarkim të të pandehurve **Besjan Ramaj, Leonard Ramaj, Ardjan Malasi dhe Rajmonda Dashi**”.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Elsa Ulliri, Bib Ndreca dhe Flora Hajredinaj, me vendimin Nr. **65**, datë **17.10.2025** vendosi:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Besjan Ramaj** për kryerjen e veprës penale *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 paragrafi i dytë i K.Penal dhe dënimit e tij me 10 vite burgim.
2. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Besjan Ramaj** për kryerjen e veprës penale *"Grupi i strukturuar kriminal"*, parashikuar nga neni 333/a paragrafi i parë i K.Penal.
3. Në zbatim të nenit 406 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Besjan Ramaj** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 6 vite e 8 muaj burgim.
4. Vuajtja e dënimit fillon nga momenti i ekzekutimit të këtij vendimi dhe të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.
5. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Leonard Ramaj** për kryerjen e veprës penale *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 paragrafi i dytë i K.Penal dhe dënimit e tij me 7 vite e 6 muaj burgim.
6. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Leonard Ramaj** për kryerjen e veprës penale *"Grupi i strukturuar kriminal"*, parashikuar nga neni 333/a paragrafi i dytë i K.Penal.
7. Në zbatim të nenit 406 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Leonard Ramaj** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 5 vite burgim.
8. Vuajtja e dënimit fillon nga momenti i ekzekutimit të këtij vendimi dhe të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.
9. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ardjan Malasi** për kryerjen e veprës penale

"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 paragrafi i dytë i K.Penal dhe dënimin e tij me 9 vite burgim.

10. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Ardjan Malasi** për kryerjen e veprës penale *"Grupi i strukturuar kriminal"*, parashikuar nga neni 333/a paragrafi i dytë i K.Penal.
11. Në zbatim të nenit 406 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Ardjan Malasi** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 6 vite burgim.
12. Vuajtja e dënimit fillon nga momenti i arrestimit dhe të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.
13. Deklarimin fajtor të të pandehurës **Rajmonda Dashi** për kryerjen e veprës penale *"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"*, kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 287 paragrafi i dytë i K.Penal dhe dënimin e saj me 7 vite burgim.
14. Në zbatim të nenit 406 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës **Rajmonda Dashi** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 4 vite e 8 muaj burgim.
15. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të mëtejshëm të këtij dënimi, duke e vënë në provë të pandehurën Rajmonda Dashi, për një periudhë kohe prej 3 vitesh me kusht që gjatë kësaj kohe, të mos kryejë asnjë vepër tjetër penale si dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës.
16. Në bazë të nenit 389 të K.Pr.Penale deklarohet heqja e masës së sigurimit "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" dhe "Ndalimi për të dalë jashtë shtetit", parashikuar nga neni 234 dhe 233 i K.Pr.Penale dhe caktuar ndaj të pandehurës Rajmonda Dashi me anë të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
17. Në bazë të nenit 190, pika 1, gërma "a" të K.Pr.Penale provat materiale si: aparat telefonik celular i markës "Nokia", model "3310 TA-1006", me kartë sim të kompanisë "Vodafone" me numër serial *****, sekuestruar shtetasit Ardjan Malasi; Aparat telefonik celular i markës "iPhone X", me kartë sim të kompanisë "One" me numër serial *****, sekuestruar shtetasit Ardjan Malasi; Aparat telefonik celular i markës "iPhone 13", sekuestruar shtetasen Rajmonda Dashi; Njësi kompjuterike sekuestruar në zyrën e shoqërisë "Ledio 04" me numër serial ***** dhe shuma e parave prej 2095 euro dhe 239500 lekësh sekuestruar në automjetin e të pandehurit Ardjan Malasi.
18. Qëndrimin në fashikull të provave materiale: DVD me të dhënat e përfuara nga akti i ekspertimit nr. 49 datë 28.03.2024; USB e markës "Verbatim" me të dhënat e përfuara nga akti i ekspertimit nr. 55 datë 03.04.2024; Hard disk i jashtëm markës "Verbatim" me të dhënat e përfuara nga akti i ekspertimit nr. 184; Fotokopje e regjistrimit noterial me mbishkrimin në kapakun me ngjyrë vishnje, noter L.M. Në faqen e parë të regjistrimit noterial fillon me aktin noterial nr. ***** rep. Nr. *****kol. datë 13.06.2023 dhe veprimi i fundit noterial është me nr. ***** rep. datë 05.10.2023, gjithsej 78 fletë, sekuestruar shtetasit L.M, me proceverbalin e datës 09.11.2023; Dokumentave të sekuestruara në datën 26.10.2023 nga numri

1 deri në numrin rendor 31 sekuestruar në banesën e të pandehurit Ardjan Malasi; Dokumentave të sekuestruara në datën 26.10.2023 nga numri 2 deri në numrin rendor 7 sekuestruar në banesën e të pandehurës Rajmonda Dashi.

19. Në bazë të nenit 190, pika 1, gërma "ç" të K.Pr.Penale kthimin e provave materiale të pandehurve: Njësi qëndrore e markës "Dell", me Service tag ****, Express Service Code ****, sekuestruar shtetasit L.M me proceverbalin e datës 09.11.2023. nëntë 9 (nëntë) regjistra noterial sekuestruar shtetasit L.M, me proceverbalin e datës 09.11.2023, shtetasit L.M. Një çantë krahu lëkure me rrip, me ngjyrë blu e errët, me mbishkrimin "ARMANI JEANS", sekuestruar shtetasit Ardjan Malasi. Pasaportë shqiptare e shtetases Rajmonda Dashi me nr. ****.
20. Shpenzimet proceduriale në fazën e hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurve në mënyrë solidare.
21. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Tiranë, më datë 20.10.2025

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar